

L I G J
Nr.7916, datë 12.4.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7698, DATË 15.4.1993 “PËR KTHIMIN DHE
KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993, neni 1 ndryshohet si vijon:

“Ky ligj u njeh ish-pronarëve a trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara ose të konfiskuara sipas akteve ligjore (duke përfshirë edhe ligjin nr.37, datë 13.1.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”), nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944, ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin a kompensimin e tyre”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

“Për efekt të njohjes, kthimin a kompensimit të pronave, me tokë, sipas këtij ligji, do të kuptohet trualli, toka bujqësore dhe jobujqësore.

Me truall do të kuptohet toka që është hipotekuar dhe që ndodhej brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara në momentin e shpronësimit. Në rastin kur qendra e banuar nuk ka asnjë vijë kufizuese, me truall do të kuptohet sipërfaqja e tokës që zë objekti i ndërtuar dhe sheshi (oborri) funksional për të. Sipërfaqja e objektit konsiderohet 25 për qind e sipërfaqes së oborrit funksional, kur në dokumentet e pronësisë nuk vërtetohet ndryshe.

Me tokë bujqësore si dhe jobujqësore do të kuptohet toka që ndodhej jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara në momentin e shpronësimit, por që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është ndryshuar në truall. Në rastet kur qendra e banuar nuk ka asnjë vijë kufizuese ose kur ajo ekziston dhe organi që e përcakton, bazuar në dokumente zyrtare që e vërtetojnë destinacionin për ndërtime të atij territori, gjykon se duhet të zgjerohet a plotësohet, si një vijë kufizuese e qendrës së banuar e monentit të hyrjes në fuqi të këtij ligji do të konsiderohet ajo që do të miratojë organi përkatës”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve a trashëgimtarëve të tyre pronat që në momentin e daljes së këtij ligji ekzistojnë në formën e trojeve, tokave bujqësore ose jobujqësore të pazëna apo ndërtesave të pandryshuara, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj”.

Neni 4

Në nenin 5, në paragrafin e parë të hiqen fjalët “për trojet” dhe të zëvendësohen me fjalët “me sipërfaqe ekuivalente”.

Neni 5

Në nenin 11, në paragrafin e parë, pas fjalës “trualli” shtohen edhe fjalët “toka bujqësore ose

jobujqësore”

Në këtë nen shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

“Nuk i kthehen ish-pronarit sipas përcaktimit të sipërm ato sipërfaqe toke që janë ndarë në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

Neni 6

Në nenin 19, në paragrafin e tretë bëhet zëvendësimi i fjalëve “Për tokën” me fjalët “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”.

Neni 7

Në nenin 21, pas fjalës “trojet” shtohen edhe fjalët “toka bujqësore ose jobujqësore”.

Neni 8

Në nenin 24, paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

“Të dënuarit për përvetësim të pasurisë së popullit në përpjesëtime të mëdha në masën që është e barabartë me vlerën e dëmit të papaguar, përcaktuar me vendimin e gjykatës”.

Neni 9

Pas nenit 27 shtohet neni 27/a me këtë përmbajtje:

“Kundër vendimit të komisionit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve, pjesëmarrësit në proces kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit.

Vendimi që jepet në këtë rast nga gjykata e rrethit është i ankueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në kodin e procedurës civile.

Procesi i kthimit të pronave ish-pronarëve nuk mund të pengohet. Vendimet e komisioneve të kthimit të pronave nuk mund të pezullohen, as me vendim gjykate edhe kur ka filluar apo vazhdon procesi gjyqësor. Zbatohen vetëm vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1072, datë 20.4. 1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha